

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

### SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e përgjithshme – drejtimi natyror

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në poezi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	8c	9a	9b	10
Pikët													
Kërkesa	11a	11b	12a	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19
Pikët													
Kërkesa	20	21	22a	22b	23	24a	24b	24c	25				
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Franc Kafka****Letër Babait**

(Fragment)

Asnjëherë nuk e kam kuptuar mungesën e plotë të ndjeshmërisë për dhimbjen dhe turpin që më kaplonte nga fjalët dhe gjykimet e tua, sikur nuk ishe i vetëdijshëm për pushtetin që zotëroje. Sigurisht edhe unë të kam hedhur ndonjë fjalë çapraz, e di mirë këtë gjë, por nuk arrija dot ta mbaja veten e t'i masja fjalët dhe pendohesha sapo i nxirrja nga goja. Ndërsa ti, me fyerjet e tua, vrisje e prisje, mbarë e prapë, pa kursyer askënd; para teje njeriu e ndjente veten krejtësisht të pambrojtur.

Kështu ishte ndërtuar sistemi yt edukativ. Them se në këtë fushë je me të vërtetë i talentuar; padyshim me një tip të ngjashëm me tëndin edhe mund të të kish ecur, duke e edukuar sipas mënyrës sate; do ta kish kuptuar logjikën e fjalëve, nuk do ta kish vrarë mendjen për të tjera gjëra dhe qetësisht do të kish bërë atë që duhej. Për mua, një copë çilimi, gjithë ç'ka urdhëroje ishte, padyshim, një porosi qiellore; kurrë s'e kam harruar këtë dhe kjo bëhej njësia matëse me të cilën gjykoja botën, sidomos ty, dhe pikërisht këtu gabove fund e krye.

Meqë në vogëlinë time piqeshim më së shumti në tryezë, rëndom mësimet e tua kishin të bënin me sjelljen time gjatë ngrënies. Duhej të haja ç'më vinin përpara, ishte e ndaluar të shprehja gjykime mbi cilësinë e gatimeve - ndërsa ty, shpeshherë, ta shpifnin, i quaje "pisllëqe"; "ajo kafsha" (kuzhinierja) e kishte katranosur. Ti, me atë oreks ujku që kishe, gjithë dëshirë për të gëlltitur kafshata të mëdha që s'i lije gjellët as të ftoheshin, haje me babëzi dhe doje që fëmija të nxitonte.

Baba, shpresoj të më kuptosh drejt, këto ishin vogëlsira të papërfillshme; për mua bëheshin cingëritëse vetëm kur ti, njeriu që ishe zot në sytë e mi, nuk u përmbaheshe urdhrave që më kishe diktuar. Për rrjedhojë, bota për mua, ndahej në tri pjesë: në të parën unë, skllavi, jetoja nën trysninë e ligjeve të hartuara vetëm për mua, të cilave s'ua dija kuptimin dhe nuk arrija t'u përshtatesha; pastaj ekzistonte një botë e dytë, pafundësisht e largët nga imja, në të cilën jetoje ti, ku drejtoje, caktoje urdhrat dhe zemëroheshe kur nuk zbatoheshin; dhe, së fundi, një botë e tretë, ku njerëzia jetonin të lumtur, pa marrë urdhra dhe pa iu bindur kurrkujt.

Për pyetjet 1-6 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Motivet kryesore që trajton Kafka në këtë krijim janë: **1 pikë**
- A) dilema dhe vendosmëria.  
B) frika dhe nënshtrimi.  
C) harresa dhe pendimi.  
D) kapërcimi dhe zgjidhja.
2. Autori na flet për marrëdhënie njerëzore: **1 pikë**
- A) mes njerëzve të njohur prej vitesh.  
B) mes njerëzve që takohen rastësisht.  
C) mes brezave, babait dhe fëmijës.  
D) mes pjesëtarëve të një fisi të madh.
3. Kjo mënyrë të shkruari, bën pjesë në llojin e rrëfimit: **1 pikë**
- A) autobiografik.  
B) biografik.  
C) filozofik.  
D) eseistik.
4. Teknika e komunikimit, e zgjedhur nga Kafka këtu është: **1 pikë**
- A) dialogu.  
B) analiza.  
C) monologu.  
D) konstatimi.
5. Ideja e tjetërsimit të njeriut dhe vetmisë e afron Kafkën me: **1 pikë**
- A) ekzistencializmin.  
B) surrealizmin.  
C) romantizmin.  
D) realizmin.
6. Arsyeja e përdorimit të fjalive të gjata në fragment është: **1 pikë**
- A) të japë ngarkesën emocionale.  
B) të përshkruajë të plotë figurën e të atit.  
C) të mbështesë idenë e tij mbi moralin.  
D) t'i japë ritëm rrëfimit.
7. Lexo me vëmendje pjesën. Gjej gjatë leximit të paragrafit të parë fjalën që tregon se si ndjehet personazhi kryesor përballë veprimeve të të atit. **1 pikë**

8. Personazhi kryesor këtu është një fëmijë i rritur. Tashmë, ai e sheh botën ndryshe, duke qenë i aftë të bëjë dallimet e të gjitha veprimeve. Emërto me një fjalë ose fjali të vetme tri pjesët e botës që ai dallonte, kur ishte fëmijë.

3 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

9. Shprehja: “*Them se në këtë fushë, je me të vërtetë i talentuar*”, ka tonalitet të veçantë, i cili mbart një nëntekst. Cili është kuptimi i nëntekstit dhe me ç’figurë stilistike shprehet ai?

2 pikë

a) nënteksti: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) figura e përdorur: \_\_\_\_\_

10. Kafka këtu sjell një realitet familjar personal. Si shfaqet ky realitet? Dallo një fakt që tregon mënyrën e sjelljes së babait dhe një opinion të autorit për këtë fakt. Interpretolidhjen midis faktit dhe opinionit.

4 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

11. Shkruaj dy folje që tregojnë arbitraritetin e babait:

2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_



**PJESA II****Jeronim de Rada****Serafina Topia**

(Fragment)

I. Ish mesditë edhe vallja  
 Të hareshme e pa kujdesje  
 Si t'ish gjallë koha e pleqve  
 E gjet shtëpinë krenare  
 Të Gjonit të Kastriotëve.  
 Mbi fron të praruar rrinte  
 Nusja, e bija e Arianitit  
 Shqepzëngritur përmbi ballë  
 Nga shkrepnin kejza e gërshetat.  
 Zonja e bujarisë s'Arbrit  
 Kryelartë e ndjente veten  
 Tek kujtonte se kish burrë  
 Prijsin e kalorësve.

.....

II. Në kësish mejtime zhytur  
 Gra fytyrprera hyjnë  
 Që nga dera e thërrasin: “Zonjë,  
 Ngrehu, në e do tët shoq,  
 Se po vriten!” Zonja Finë  
 Brof në këmbë edhe ndjek gratë  
 Gjer në dhomën e altarit  
 Të martesës, ku dy trima  
 Nik dhe Bozdar përballen  
 Kordhët tehmprehta ndër duar...  
 Por në çast e ëma e prijësit  
 Vetë zonja Vojsavë,  
 Me dy duar të saj dy tehat  
 E kordhëve të tyre mbajti;

.....

III. Serafina shpejt të shoqin  
 E rrëmben përkrahu e i thotë:  
 “Mbi ne fajin do ta hedhin!  
 Ne në jug na përçmojnë  
 Porsi malësorë t'egër  
 Shkojmë Nik në shtëpi tonë  
 Që mos të helmojmë më  
 Prijsin e kalorësve  
 Në pallat ku i jemi miq“  
 Lanë dasmën. Dhe me ta  
 N'heshtje nisën dhe shqiptarët  
 përmbi kuaj. E asnjë s'thoshte  
 çfarë bluante në tru.

Për pyetjet 13-19 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. “Serafina Topia” bën pjesë në llojin e poemës:

1 pikë

- A) epiko-lirike.
- B) liriko-epike.
- C) liriko-dramatike.
- D) dramatike.

14. Subjekti i kësaj poeme,shërben për të na paraqitur:

1 pikë

- A) një portret të prijësit të këtij vendi.
- B) një model të plotë të gruas në familje.
- C) një ide filozofike për lirinë e individit.
- D) një pasqyrë të gjerë të jetës njerëzore.

15. Në këtë poemë ndërthuren:

1 pikë

- A) filozofia me historinë.
- B) e bukura me të shëmtuarën.
- C) historia me fantazinë.
- D) e mira me të keqen.

16. Vetë poeti identifikohet më tepër:

1 pikë

- A) me heroin lirik.
- B) me heroin epik.
- C) me heroin dramatik.
- D) me heroin tragjik.

17. Duke u nisur nga dyluftimet greke dhe arsyeja e tyre, ndeshja midis dy trimave Nik dhe Bozdar, të ngjason me dyluftimin midis:

1 pikë

- A) Paridit dhe Menelaut.
- B) Hektorit dhe Akilit.
- C) Hektorit dhe Patroklit.
- D) Paridit dhe Akilit.

18. Grupi emëror “**Koha e pleqve**”, në pjesën e parë, nënkupton:

1 pikë

- A) kohën e shkuar kur gjithçka ishte e artë.
- B) kohën e luftës dhe të rezistencës shqiptare.
- C) kohën kur bëheshin dasma të bukura.
- D) kohën kur njerëzit lëviznin lirisht.

19. Qëndrimi i autorit ndaj trimave është:

1 pikë

- A) indiferent.
- B) dashamirës.
- C) ironik.
- D) adhurues.

20. Në poemën e De Radës gjejmë personazhe historikë dhe personazhe të trilluar. Shkruaj një për secilin rast. **2 pikë**

---



---



---

21. De Rada është shkrimtar romantik. Gjej dy tipare të romantizmit që dalin në këtë fragment dhe ilustro me shembull secilin prej tyre. **4 pikë**

---



---



---

22. Gjej dy epitete që janë fjalë të përbëra. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

23. Për çfarë shërbejnë fjalët e korit të grave, kur lajmërojnë Finën, rreth dyluftimit të trimave? Në ç'mënyrë është folja “ngrehu”? **2 pikë**

---



---



---

24. Ku përqendrohet vëmendja e autorit në secilën nga pjesët e fragmentit? **3 pikë**

a) fragmenti I \_\_\_\_\_

b) fragmenti II \_\_\_\_\_

c) fragmenti III \_\_\_\_\_

25. Ky fragment përshkohet nga një situatë dramatike. Përshkruaje atë. Ç'rol luajnë Serafina dhe Vojsava në zgjidhjen e kësaj situatë? **4 pikë**

---



---



---



---



---